

VENDIM
Nr. 30, datë 26.3.2012

PËR ZGJERIMIN E ZONËS SË LICENCIMIT PËR TELEVISIONIN PRIVAT VENDOR “TV ADRIAMED” PËR SUBJEKTIN: SHOQËRIA “ADRIA MED” SHPK

Në mbështetje të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Për licencimin e operatorëve privatë për transmetim radioteleviziv analogjik tokësor në nivel vendor”, miratuar me vendimin nr. 355 pika 1, datë 29.8.2005, rregullores “Kriteret për dhënien e licencave për transmetime televizive dhe radio FM analoge tokësore në nivel vendor”, miratuar me vendimin nr. 355 pika 2, datë 29.8.2005 dhe rregullores “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr. 1, datë 29.1.2010 të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit, pasi mori në shqyrtim kërkesën e shoqërisë “Adria Med” sh.p.k., për zgjerimin e zonës së licencimit dhe mbështetur në propozimin e komisionit të shqyrtimit të dokumentacionit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të miratojë zgjerimin e zonës së licencimit të shoqërisë “Adria Med” sh.p.k., për televisionin privat vendor “Tv AdriaMed”, sipas licencës nr. 098/TVL, në rrethin e Kavajës dhe qarqet Fier dhe Vlorë.
2. Karakteristikat teknike janë pjesë përbërëse e licencës përkatëse dhe u nënshtrohen të gjitha kushteve të saj.
3. Ngarkohet administrata e KKRT-së për pasqyrimin e ndryshimeve përkatëse në licencën e subjektit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati